R E P U B L I K A   E   K O S O V Ë S
/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË /OSNOVNI SUD U MITROVICI / BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr. 246/2012

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditses; nga te cilin e perfaqsona Avokat ne sipas autorizimit me shkrim, kunder te padtures; Komuna e te cilen e perfaqson Avokati baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlera e lendes se kontestit; 3.100,oo Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.25. 09.2014 jep kete;

## A K T G J Y K I M

**I-APROVOHET** kerkespadia e paditeses; nga dhe **VERTETOHET** se e njejta ka te drejten e shfrytzimit te perhershem te tokes e cila evidentohet si ngastra katastrale me kultur oborr ne vendin e qujtur " , me masa dhe kufi qe jane shenuar ne kopjen e planit dhe te ekspertizes gjeodete dt. 13.06.2014 e cila evidentohen ne emer te P.SH. Kuvendi Komunal 1/1, ZK-

**II- DETYROHET** e paditura qe ti njoh kete te drejte paditses dhe te lejojne qe paditesja kete palujtshmeri ta regjistroje ne emer te saje prane Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te proedures kontestimore

## A r s y e t i m

Paditesja ne padin e parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te saje ne seancat e mbajtura ka theksuar se e njejta eshte pronare e baneses e cila gjendet ne Rr, nr Pronesin ne kete banes e ka fituar ne baze te Kontrates mbi blerjen e baneses Vr. nr. dt. 19.03.1999 te vertetuar nga Gjykata Komunale ne

Kete palujtshmeri paditesja e shfrytzon pa u penguar nga askush qe nga 30.03.1989 kur i eshte ndar bashkshortit te saje tani te ndjer.

Kjo banese shtrihet ne parcelen e cekur ne dispozitiv dhe kjo parcele eshte ne kuader te shtepise e cila eshte blere dhe e njejta eshte e rrethekuar me mur te larte .

I autorizuari i paditses ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi

Perfaqsuesi i te paditures e kontestoi padin dhe kerkespadin duke cekur se epilogu i vendimit duhet te jet mbi bazen e rezultateve te provave dhe natyres se regjimit te palujtshmeruise dhe statusit te nderteses te cekur ne kerkespadi.

Shpenzimet e perocedures kontestmore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Certifikaten e prones se palujtshme – dt. 06.11.2014. Kontraten mbi blerjen e baneses Vr. Nr. dt. 19.03.1996, Ekspertizen e ekspertit gjeodet i dt 13.06.2014, kopjen e planit dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Certifikatat e pronesis e sipercekur, vertetohet se palujtsheria tani lendore evidentohet ne emer te paditures .

Nga Kontrata mbi blerjen e baneses te sipercekur vertetohet se paditesja eshte pronare e baneses perdhese e cila gjendet ne Rr nr. ne sip 25m2.

Nga ekspertiza gjeodete e sipercekur , konstatohet se ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon Drejtoria per Gjeodezi Kataster dhe Prone ne , eshte vertetuar se palujtshmeria kontestuese, bie gjegjsisht e perbene parc. e cekur me larte me masa dhe kufi te shenuar si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe kopjen e planit e cila eshte pjese perberse e kesaje ekspertize dhe e aprovuar si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.

Nga Kopja e planit shifet shtrirja perkufizimi dhe siperfaqja e palujtshmerise tani lendore.

Nga provat e sipercekura me pamedyshje argumentohet fakti se padtsja eshte pronare e baneses perdhese ne baze te Kontrates mbi blerjen e baneses se sipercekur dhe e kjo banes shtrihet ne par. kat. te cekur ne dispozitiv dhe paditesja poashtu e ka ne shfrytzim token e cila eshte rreth shtepise qe nga vit. 1989 , kur bashkshortit te saje iu eshte ndar banesa ne shfrytzim te cilen banese paditesja e ka privatizuar ne vit. 1989.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim– si paditesja si pronare faktike dhe juridike e baneses-shtepis se sipercekure per shfrytzimin e domosdoshem dhe te rendomt te shtepise ka te drejten e shfrytzimit te perhershem te tokes-oborrit perreth saje ., parandaj vendosi si ne dispozitiv., bazuar ne nen 36 dhe 37 te Ligjit per Pronesin dhe te drejtat tjera sendore

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen. 450 te LPK

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.246/2012 dt.25.09.2014

Gjyqtari,
Ragip Kadriu,

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit te Kosoves e permes kesaje gjykate.